




**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 6 paragrafi (2) dhe neni 26 paragrafi (1) nën paragrafi (1.1), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

## **UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2023 PËR PËRJASHTIM GRUPOR TË MARRËVESHJEVE PËR TRANSFERIM TË TEKNOLOGJISË**

### **Neni 1 Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet që duhet të përbahen në marrëveshjet dhe praktikat e bashkërenduara për transferimin e teknologjisë, si dhe kufizimet apo kushtet që këto marrëveshje nuk mund të përbajnë për t'i përjashtuar nga ndalimi i përgjithshëm i nenit 5 të Ligjit për Mbrojtja e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

### **Neni 2 Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohen përkufizimet në vijim:

a) "Marrëveshje" nënkupton marrëveshjet e çdo forme të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa fuqi detyruese, vendime ose rekomandime të grupeve të ndërmarrjeve, si dhe praktika të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve që operojnë në të njëjtin nivel ose në nivele të ndryshme të tregut.

b) "Të drejta teknologjike" do të thotë njojuri dhe të drejtat e mëposhtme, ose një kombinim i tyre, duke përfshirë aplikimet për këto të drejta ose aplikimet për regjistrimin e këtyre të drejtave:

(I) patentat,

(II) modelet e shërbimeve,

(III) të drejtat e dizajnit,

(IV) topografit e produkteve gjysmë-përçuese,

(V) certifikatat shtesë të mbrojtjes për produktet mjekësore ose produkte të tjera për të cilat mund të merren certifikata të tilla mbrojtjeje plotësuese,

(VI) certifikatat e seleksionuesit të bimëve dhe

(VII) të drejtat e autorit të softuerit;

c) marrëveshje për transferimin e teknologjisë do të thotë:

(I) një marrëveshje licencimi për të drejtat e teknologjisë, e lidhur ndërmjet dy ndërmarrjeve me qëllim të prodhimit të produkteve të kontratës nga i licencuari dhe/ose nën-kontraktori (ët) e tij,

(II) një caktim i të drejtave të teknologjisë ndërmjet dy ndërmarrjeve për qëllimin e prodhimit të produkteve të kontratës ku një pjesë e irrezikut që lidhet me shfrytëzimin e teknologjisë mbetet tek ceduesi;

d) "Marrëveshje reciproke" nënkupton një marrëveshje për transferimin e teknologjisë ku dy ndërmarrje i jep njëra-tjetrës, në kontratat e njëjta ose të veçanta, një licencë për të drejtat e teknologjisë, dhe kur ato licenca kanë të bëjnë me teknologjitë konkuruese ose mund të përdoren për prodhimin e produkteve konkuruese;

e) "marrëveshje jo reciproke" nënkupton një marrëveshje për transferimin e teknologjisë ku një ndërmarrje i jep një ndërmarrjeje tjetër një licencë për të drejtat e teknologjisë, ose kur dy ndërmarrje i jep njëra-tjetrës një licencë të tillë, por kur ato licenca nuk kanë të bëjnë me teknologjitë konkuruese dhe nuk mund të përdoren për prodhimin e produkteve konkuruese;

(f) "produkt" nënkupton mallrat ose një shërbim, duke përfshirë të dy llojet, si mallrat dhe shërbimet ndërmjetëse po ashtu edhe mallrat dhe shërbimet përfundimtare;

(g) "produkt i kontratës" nënkupton një produkt të prodhuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në bazë të të drejtave të licencuara të teknologjisë;

(h) "Të drejtat e pronësisë intelektuale" përfshin të drejtat e pronësisë industriale, në veçanti patentat dhe markat tregtare, të drejtat e autorit dhe të drejtat fqinje;

(i) "njoħuri" nënkupton një paketë informacioni praktik, që rezulton nga përvoja dhe testimi, i cila eshtë:

(I) sekret, që do të thotë, i pa njoħur përgjithësish ose i pa-arritshem lehtësish,

(II) thelbësore, domethënë të rëndësishme dhe të dobishme për prodhimin e produkteve të kontratës, dhe

(III) të identikuara, domethënë të përshkruara në një mënyrë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të bëjë të mundur verifikimin nëse plotëson kriteret e fshehtësisë dhe përbajtjes;

(j) "tregu përkates i produktit" eshtë tregu që përfshin të gjitha mallrat ose shërbimet që konsiderohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për shkak të karakteristikave, çmimeve dhe përdorimit të synuar;

(k) "tregu përkates i teknologjisë" do të thotë tregu për të drejtat e licencuara të teknologjisë dhe zëvendësuesit e tyre, domethënë të gjitha ato të drejta teknologjike që konsiderohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga i licencuari, për shkak të karakteristikave të të drejtave të teknologjisë, honorarët të pagueshme në lidhje me këto të drejta dhe përdorimin e tyre të synuar;

(l) "treg përkates gjeografik" nënkupton tregun që përfshin zonën në të cilén ndërmarrjet në fjalë janë të përfshira në ofertën dhe kérkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilin kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene dhe që mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinje;

(m) "tregu përkates" nënkupton tregun e një produkti të caktuar në një zonë të caktuar gjeografike;

(n) "ndërmarrje konkuruese" nënkupton ndërmarrjet që konkurrojnë në tregun përkates, që do të thotë:

(I) ndërmarrjet konkuruese në tregun përkates ku licencoohen të drejtat e teknologjisë, domethënë ndërmarrjet që licencojnë të drejtat konkuruese të teknologjisë (konkurrentët aktualë në tregun përkates),

(II) ndërmarrjet konkuruese në tregun përkates ku shiten produktet e kontratës, domethënë ndërmarrjet të cilat, në mungesë të marrëveshjes së transferimit të teknologjisë, do të ishin aktive në tregun (tregjet) përkates në të cilin shiten produktet e kontratës (konkurrentët aktualë në tregun përkates) ose të cilat, në mungesë të marrëveshjes së transferimit të teknologjisë, do të kishte gjasa që, mbi baza realiste dhe jo thjesht si një mundësi teorike, në përgjigje të një rritjeje

të vogël dhe të përhershme të çmimeve përkatëse, të ndërmarrë, brenda një periudhe të shkurtër kohore, investimet e nevojshme shtesë ose kosto të tjera të nevojshme pér kalimin, pér të hyrë në tregun përkatës (konkurrentët e mundshëm në tregun përkatës);

(o) "sistem selektiv i shpérndarjes" nënkuption një sistem shpérndarjeje ku licencuesi merr përsipër të licencoja prodhimin e produkteve të kontratës, drejtpërdrejt ose térthorazi, vetëm pér të licencuarit e përzgjedhur në bazë të kritereve të specifikuara dhe ku këta të licencuar marrin përsipër të mos ua shesin produktet e kontratës shpérndarësve të paautorizuar brenda territorit të rezervuar nga licencuesi pér të operuar atë sistem;

(p) "licencë ekskluzive" nënkuption një licencë sipas së cilës vetë licencuesi nuk lejohet të prodhojë në bazë të të drejtave të licencuara të teknologjisë dhe nuk lejohet të licencoja të drejtat e teknologjisë së licencuar pér palët e treta, në përgjithësi ose pér një përdorim të veçantë ose në një territor të caktuar;

(q) "territor ekskluziv" nënkuption një territor të caktuar brenda të cilit vetëm një ndërmarrje lejohet të prodhojë produktet e kontratës, por kur është megjithatë e mundur të lejohet një i licencuar tjetër të prodhojë produktet e kontratës brenda atij territori vetëm pér një klient të caktuar ku licenca e dytë është dhënë pér të krijuar një burim alternativ furnizimi pér atë klient;

(r) "grup ekskluziv i klientëve" nënkupton një grup klientësh tek të cilët vetëm njëra palë në marrëveshjen e transferimit të teknologjisë lejohet të shesë në mënyrë aktive produktet e kontratës të prodhuara me teknologjinë e licencuar.

2. Për qëllime të këtij udhëzimi administrativ, shprehjet "sipërmarrje", "licencues" dhe i "licencuar" do të përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura.

"Ndërmarrje të lidhura" do të thotë:

(a) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e transferimit të teknologjisë, drejtpërdrejt ose térthorazi:

I. ka fuqinë pér të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose

II. ka fuqinë të emërojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen, ose

III. ka të drejtë të menaxhojë punët e ndërmarrjes;

IV. zotëron më shumë se gjysmën e kapitalit ose aseteve;

(b) ndërmarrjet të cilat në mënyrë direkte ose indirekte kanë, mbi një palë në marrëveshjen e transferimit të teknologjisë, të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a);

(c) ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në pikën (b) ka, drejtpërdrejt ose térthorazi, të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a);

(d) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e transferimit të teknologjisë së bashku me një ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në pikat (a), (b) ose (c), ose në të cilat dy ose më shumë nga këto ndërmarrjet e fundit, së bashku kanë të drejtat ose kompetencat e renditura në pikë (a);

(e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a) mbahen bashkërisht nga:

(i) palët në marrëveshjen e transferimit të teknologjisë ose ndërmarrjet e tyre respektive të lidhura të përmendura në pikat (a) deri (d), ose

(II) një ose më shumë nga palët në marrëveshjen e transferimit të teknologjisë ose një ose më shumë nga ndërmarrjet e tyre të lidhura të përmendura në pikat (a) deri (d) dhe një ose më shumë palë të treta.

### **Neni 3 Përjashtim**

1. Në bazë të nenit 5.2 të Ligjit për Konkurrencën dhe në bazë të dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ, neni 5.1 i Ligjit për Konkurrencën nuk zbatohet për marrëveshjet për transferimin e teknologjisë.

2. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 do të zbatohet në masën që marrëveshjet e transferimit të teknologjisë përmbytjanë kufizime të konkurrencës që hyjnë në fushëveprimin e nenit 5 të Ligjit për Konkurrencën. Përjashtimi do të zbatohet për aq kohë sa të drejtat e licencuara të teknologjisë nuk kanë skaduar, përfunduar ose nuk janë deklaruar të pavlefshme ose, në rastin e njohurive, për sa kohë që njohuritë mbeten sekrete. Megjithatë, kur njohuria bëhet e njohur publikisht si rezultat i veprimit të tē licencuarit, përjashtimi do të zbatohet për kohëzgjatjen e marrëveshjes.

3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 do të zbatohet gjithashtu për dispozitat në marrëveshjet për transferimin e teknologjisë, të cilat kanë të bëjnë me blerjen e produkteve nga i licencuari ose që kanë të bëjnë me licencimin ose dhënien e të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale ose të njohurive tek i licencuari, nëse, dhe në masën që, këto dispozita lidhen drejtpërdrejt me prodhimin ose shitjen e produkteve të kontratës.

### **Neni 4 Pragjet e pjesëmarrjes në treg**

1. Kur ndërmarrjet palë në marrëveshje janë ndërmarrje konkuruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 2 do të zbatohet me kusht që pjesëmarrja e bashkuar në treg e palëve të mos i kalojë 20% në tregun (tregjet) përkatës.

2. Kur ndërmarrjet palë në marrëveshje nuk janë ndërmarrje konkuruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 2 do të zbatohet me kusht që pjesëmarrja në treg e secilës prej palëve të mos i kalojë 30% në tregun (tregjet) përkatës.

### **Neni 5 Kufizime të forta**

1. Kur ndërmarrjet palë në marrëveshje janë ndërmarrje konkuruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk do të zbatohet për marrëveshjet të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt ndonjërin prej këtyre në vijim:

(a) kufizimi i aftësisë së një pale për të përcaktuar çmimet e saj kur u shet produkte palëve të treta;

(b) kufizimin e prodhimit, me përjashtim të kufizimeve në prodhimin e produkteve të kontratës të vendosura ndaj të licencuarit në një marrëveshje jo reciproke ose të vendosura vetëm ndaj njërit prej të licencuarve në një marrëveshje reciproke;

(c) ndarjen e tregjeve ose të klientëve përveç:

(I) detyrimin e licencuesit dhe/ose të licencuarit, në një marrëveshje jo reciproke, për të mos prodhuar me të drejtat e teknologjisë së licencuar brenda territorit ekskluziv të rezervuar për palën tjetër dhe/ose për të mos shitur në mënyrë aktive dhe/ose pasive në territorin ekskluziv ose tek grupi ekskluziv i klientëve të rezervuar për palën tjetër,

(II) kufizimin, në një marrëveshje jo reciproke, të shitjeve aktive nga i licencuari në territorin ekskluziv ose tek grupi ekskluziv i klientëve të ndarë nga licencuesi për një të licencuar tjetër, me kusht që ky i fundit të mos ketë qenë një ndërmarrje konkuruese e licencuesit në kohën e konkludimit të licencës së vet,

(III) detyrimi i të licencuarit për të prodhuar produktet e kontratës vetëm për përdorimin e tij, me kusht që i licencuari të mos jetë i kufizuar në shitjen e produkteve të kontratës në mënyrë aktive dhe pasive si pjesë këmbimi për produktet e veta,

(IV) detyrimi i të licencuarit, në një marrëveshje jo reciproke, për të prodhuar produktet e kontratës vetëm për një klient të caktuar, ku licenca është dhënë për të krijuar një burim alternativ furnizimi për atë klient;

(d) kufizimi i aftësisë së të licencuarit për të shfrytëzuar të drejtat e veta teknologjike ose kufizimi i aftësisë së cilësdo prej palëve në marrëveshje për të kryer kërkime dhe zhvillime, përveç rasteve kur ky kufizim i fundit është i domosdoshëm për të parandaluar zbulimin e njojurive të licencuara tek palët e treta.

2. Kur ndërmarrjet palë në marrëveshje nuk janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk do të zbatohet për marrëveshjet të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjera nën kontrollin e palëve, kanë si objekt ndonjërin këtyre në vijim:

(a) kufizimi i aftësisë së një pale për të përcaktuar çmimet e saj kur u shet produkte palëve të treta, pa penguar mundësinë e vendosjes së një çmimi maksimal të shitjes ose rekomandimit të një çmimi shitjeje, me kusht që të mos rezultojë me një çmim shitjeje fiks ose minimal si rezultat të presionit të bërë, ose stimujve të ofruar nga seila prej palëve;

(b) kufizimi i territorit në të cilin, ose i klientëve të cilëve, i licencuari mund t'u shesë pasivisht produktet e kontratës, përveç:

(i) kufizimi i shitjeve pasive në një territor ekskluziv ose në një grup ekskluziv klientësh të rezervuar për licencuesin,

(II) detyrimi për të prodhuar produktet e kontratës vetëm për përdorimin e tij, me kusht që i licencuari të mos jetë i kufizuar në shitjen e produkteve të kontratës në mënyrë aktive dhe pasive si pjesë këmbimi për produktet e veta,

(III) detyrimin për të prodhuar produktet e kontratës vetëm për një klient të caktuar, ku licenca është dhënë për të krijuar një burim alternativ furnizimi për atë klient,

(IV) kufizimi i shitjeve për përdoruesit fundorë nga një i licencuar që operon në nivel të tregtisë me shumicë,

(V) kufizimi i shitjeve ndaj shpërndarësve të paautorizuar nga anëtarët e një sistemi shpërndarjeje selektive;

(c) kufizimi i shitjeve aktive ose pasive për përdoruesit fundorë nga një i licencuar, i cili është anëtar i një sistemi shpërndarjeje selektive dhe që operon në nivelin e shitjes me pakicë, pa paragjykuar mundësinë e ndalimit të një anëtarit të sistemit të operojë nga një vend i paautorizuar të themelimit.

3. Kur ndërmarrjet palë në marrëveshje nuk janë ndërmarrje konkurruese në kohën e përfundimit të marrëveshjes, por më pas bëhen ndërmarrje konkurruese, paragrafi 2 dhe jo paragrafi 1 do të zbatohen për gjithë jetëgjatësinë e marrëveshjes, përveç rasteve kur marrëveshja ndryshohet më pas në ndonjë aspekt material. Një ndryshim i tillë përfshin konkludimin e një marrëveshjeje të re për transferimin e teknologjisë ndërmjet palëve në lidhje me të drejtat konkurruuese të teknologjisë.

## **Neni 6** **Kufizimet e përjashtuara**

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk zbatohet për asnjë nga detyrimet e mëposhtme të përfshira në marrëveshjet e transferimit të teknologjisë:

(a) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë ndaj të licencuarit për të dhënë një licencë ekskluzive ose për t'i dhënë të drejta, të plota ose të pjesshme, licencuesit ose një pale të tretë të caktuar nga licencuesi në lidhje me përmirësimet e tij ose aplikimet e reja të tij, në teknologjinë e licencuar;

(b) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë ndaj një pale për të mos kundërshtuar vlefshmérinë e të drejtave të pronësisë intelektuale që pala tjetër zotëron, pa paragjykim ndaj mundësisë, në rastin e një licence ekskluzive, për të parashikuar përfundimin e marrëveshjes së transferimit të teknologjisë në rast se i licencuari e sfidon vlefshmérinë e ndonjë prej të drejtave të licencuara të teknologjisë.

2. Kur ndërmarrjet palë në marrëveshje nuk janë ndërmarrje konkuruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk do të zbatohet për asnjë detyrim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që kufizon aftësinë e të licencuarit për të shfrytëzuar të drejtat e veta teknologjike ose aftësinë e cilësdo prej palëve në marrëveshje për të kryer kërkim dhe zhvillim, përvèç rasteve kur ky kufizim i fundit është i domosdoshëm për të parandaluar zbulimin e njohurive të licencuara për palët e treta.

## **Neni 7** **Tërheqja në raste individuale**

AKRK-ja mund ta tërheqë mbrapsht përfitimin nga ky Udhëzim Administrativ, në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, kur në ndonjë rast të veçantë konstaton se një marrëveshje për transferimin e teknologjisë, për të cilën vlen përjashtimi i paraparë në nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ, ka efekte të cilat janë të papajtueshme me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe në veçanti kur:

(a) qasja e teknologjive të palëve të treta në treg është e kufizuar, për shembull nga efekti akumulues i rrjeteve paralele të marrëveshjeve të ngjashme kufizuese që ndalojnë të licencuarit të përdorin teknologjitet e palëve të treta;

(b) qasja e të licencuarve të mundshëm në treg është e kufizuar, për shembull nga efekti akumulues i rrjeteve paralele të marrëveshjeve të ngjashme kufizuese që i ndalojnë licencuesit të licencojnë të licencuarit e tjerë, ose sepse i vetmi pronar i teknologjisë që licencon të drejtat përkatëse të teknologjisë konkludon një licencë ekskluzive me një të licencuar i cili është tashmë aktiv në tregun e produktit në bazë të të drejtave të zëvendësueshme të teknologjisë.

## **Neni 8** **Zbatimi i pragjeve të pjesëmarrjes në treg**

Për qëllimet e zbatimit të pragjeve të pjesëmarrjes (pjesës së aksioneve) në treg të përcaktuara në nenin 3, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

(a) pjesëmarja në treg do të llogaritet në bazë të të dhënave të vlerës së shitjeve në treg; nëse të dhënat e vlerës së shitjeve në treg nuk janë të disponueshme, vlerësimet e bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë vëllimet e shitjeve në treg, mund të përdoren për të përcaktuar pjesëmarrjen (aksionet) në treg të ndërmarrjes në fjalë;

(b) pjesëmarja në treg do të llogaritet në bazë të të dhënave që kanë të bëjnë me vitin kalendarik paraardhës;

- (c) pjesëmarrja në treg e zotëruar nga ndërmarrjet e përmendura në pikën (e) të nën-paragrafit të dytë të nenit 1(2) do t'i ndahet në mënyrë të barabartë secilës ndërmarrje që ka të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a) të nën-paragrafit të dytë të nenit 1(2);
- (d) pjesëmarrja në treg e një licencuesi në një treg përkatës për të drejtat e licencuara të teknologjisë do të llogaritet në bazë të prezencës së të drejtave të teknologjisë së licencuar në tregun (tregjet) përkatës (që është tregu (tregjet) e produktit dhe tregu (tregjet) gjeografik ku shiten produktet e kontratës, që rezulton në bazë të të dhënave të kombinuara të shitjeve në lidhje me produktet e kontratës të prodhua nga licencuesi dhe të licencuarit e tij;
- (e) nëse pjesëmarrja në treg e përmendur në nenin 3(1) ose (2) fillimisht nuk është më shumë se 20% ose 30% respektivisht, por më pas rritet mbi këto nivele, përashtimi i parashikuar në nenin 2 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej dy vitesh kalendarikë radhazi pas vitit në të cilin është tejkaluar për herë të parë pragu 20% ose pragu 30%.

**Neni 12**

**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neime Binaku-Isufi

Kryetare e Autoritetit të Konkurrëncës të Republikës së Kosovës

